



01 Nr. 697/24 Dt. 08.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, Aneks Memorandumit të Bashkëpunimit -Përditësimi i numrit të përfituesve të komponentës “Ofrimi i mundësive të punësimit të lehtësuar në kompanitë ekzistuese” KOS2202-C3 ndërmjet projekti: “INTEGRA-Nxitja e riintegritit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cënueshëm lokal në Kosovë” të nënshkruar ndërmjet Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik –PREDA Plus Kosovë dhe WEntrepreneur dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 686/24 të datës 05.11.2024, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e mjeteve për bashkëfinancim të projektit

1. Lejohen mjetet financiare për participim (bashkëfinancim) në realizimin e projektit: “INTEGRA-Nxitja e riintegritit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cënueshëm lokal në Kosovë”, i cili participim (bashkëfinancim) është i bazuar në nenin 4 (Përgjegjësi e Palëve) të Aneks Memorandumit të Bashkëpunimit -Përditësimi i numrit të përfituesve të komponentës “Ofrimi i mundësive të punësimit të lehtësuar në kompanitë ekzistuese” KOS2202-C3 ndërmjet projektit: “INTEGRA-Nxitja e riintegritit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cënueshëm lokal në Kosovë” të nënshkruar ndërmjet Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik –PREDA Plus Kosovë dhe WEntrepreneur dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 686/24 të datës 05.11.2024, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 320.00 € (treqind e njëzetë euro).
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Aneks Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet projektit: “INTEGRA-Nxitja e riintegritit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cënueshëm lokal në Kosovë” të nënshkruar ndërmjet Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik –PREDA Plus Kosovë dhe WEntrepreneur dhe Komunës së Prizrenit 01 nr. 686/24 të datës 05.11.2024.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - OJQ PREDA Plus,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

